



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë - Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy

Në bazë të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 Mars 2019), nenit 12 të Rregullores (MF) Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë, nxjerr këtë:

VENDIM

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programme të organizatave jo-qeveritare në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), Energjisë, dhe sektorin Minerar.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Ministrisë së Ekonomisë, kodi i organizatës buxhetore 213, në kuadër të kategorisë ekonomike Subvencione the Transfere në kuadër të programit/nënprogramit 11413.

II

1. Mjetet e përmendura në nenin do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshin:

1. Teksti i thirrjes publike;
2. Udhëzimet për aplikuesit;
3. Formularët e aplikimit;
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve;
5. Format për raportimin e zbatimit të projektit.

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit;
2. Forma e buxhetit të programit apo projektit;
3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta;
4. Deklarata e partneritetit (nëse është e aplikueshme);
5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike;
6. Forma e deklaratës mbi aktivitetet e përshkruara të programit/projektit.

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit;
 2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin;
 3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit.

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare <https://me.rks-gov.net/>.

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të dhe udhëzimet për aplikuesit, Ministria e Ekonomisë do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftojë përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit.

Prishtinë, 08.03.2022

Vendimi u dërgohet:

- Ministres së Ekonomisë
- Udhëheqësit të DFSHP
- Arkivit të Ministrisë së Ekonomisë

Leonita Shabani Mullarama



Zv. Sekretare e Përgjithshme